



Prishtinë, 3 tetor 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_842\_2016

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 13 par 1 dhe nenin 14 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë;
- Nenin 4 paragrafi 9, 10 dhe 11 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Vendimin nr. V-810-2016 dt. 19 maj 2016 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;
- Aplikacionin/Kërkesën për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Madanaj-Rrypaj, ZK Kusar, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, në Komunën e Gjakovës, të datës 17.05.2016 të shoqërisë "Energy Development Group - Kosova" L.L.C., me adresë: rruga Soliteri "Avalla" P + 12, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës, dhe
- Aplikacionin për Pranin në Skemën Mbështetëse;

**në seancën e mbajtur me datë 3 tetor 2016 nxori këtë:**

**V E N D I M**

**Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar**

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se shoqëria "Energy Development Group - Kosova" L.L.C., ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Madanaj - Rrypaj, ZK Kusar, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, në Komunën e Gjakovës, Republika e Kosovës.
- II. Aplikuesit "Energy Development Group - Kosova" L.L.C., do t'i lëshohet AUTORIZIMI për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga panelet solare/fotovoltaike, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe



kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.

- III. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimentit të ri gjenerues para se t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.
- IV. Vendimi mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar përcakton se, procesi për pranim në skemën mbështetëse do të ndalohej derisa, të lirohen caqet e disponueshme sipas Udhëzimit Administrativ nr. 01/2013 të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Republikës së Kosovës.
- V. Me Vendimin mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar përcaktohet se aplikacioni i shoqërisë "Energy Development Group - Kosova" L.L.C., konsiderohet si aplikacion "në pritje", për pranim në skemën mbështetëse.
- VI. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar lëshohet për periudhë një (1) vjeçare, brenda së cilës periudhë aplikuesi obligohet që ti plotësoi kërkesat sipas pikës II. të diapozitivit të këtij Vendimi, dhe me shkrim të kërkojë lëshimin e Autorizimit për ndërtim të stabilimenteve të reja gjeneruese.
- VII. Afati i Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar i përcaktuar me dispozitivin nën pikën VI. i këtij vendimi, do të fillojë të rrjedh, jo nga data e lëshimit të këtij vendimi, por nga data e njoftimit me shkrim nga ZRRE për përfshirje në skemën mbështetëse.

### **A r s y e t i m**

- ZRRE me datë 17.05.2016 nga shoqëria "**Energy Development Group - Kosova**" L.L.C., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapacitetit të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Madanaj, ZK Kusar, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, në Komunën e Gjakovës, Republika e Kosovës.
- ZRRE me datë 17.05.2016 nga shoqëria "**Energy Development Group - Kosova**" L.L.C., ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse.
- ZRRE- me datë 13.06.2016 i ka lëshuar njoftimit shoqërisë "**Energy Development Group - Kosova**" L.L.C., ku ka theksuar se: ZRRE ka pranuar/evedetuar disa aplikacione për ndërtimin e paneleve solare ku kapaciteti i të cilave ka PËRMBUSHUR caqet për shfrytëzimin dhe mbështetjen e prodhimit të energjisë nga BRE-të,të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013 të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Po ashtu ka njoftuar se me Rregullën për Pranim në Skemën Mbështetëse tarifa nxitëse "Feed in" do ju gandohet vetëm aplikuesëve që kanë marr Autorizim Preliminar apo final që janë brenda caqeve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013.
- ZRRE në njoftimin përkatës ka njoftuar se: nëse aplikuese dëshiron të vazhdojë me procedurat për marrjen e Vendimit Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar apo Autorizimin Final, në vendimin përkatës do të specifikohet se procesi për pranim në skemën mbështetëse do të



ndalohet derisa të lirohen caqet e disponueshme sipas Udhëzimit Administrativ nr. 01/2013, dhe ka sqaruar se ZRRE do e njoftoj aplikuesin sipas rendit të aplikacioneve me rastin e lirimit të caqeve të disponueshme.


- ZRRE, pas vlerësimit të kërkesave dhe dëshmive relevante të bashkangjitura aplikacionit, pranimi të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe vlerësimit të përmbajtjes së aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


**VIII.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

**IX.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Krenar Bujupi, U.D. kryesues

  
Arsim Janova, anëtar

  
Qemajl Mustafa, anëtar

  
Besim Sejjaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Gjakovës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së